2.3. Kryen auditime të brendshme konform planit vjetor si dhe bazuar në kërkesa të Menaxhmentit të Lartë;	2.3.Conducts internal audits in accordance with the annual plan and based on the requirements of senior management;	2.3. Vrši interne revizije u skladu sa godišnjim planom i na osnovu zahteva više uprave;
2.4. Bën vlerësimin e funksionimit të kontrollit të brendshëm duke rekomanduar përmirësim të vazhdueshëm;	2.4.Evaluates the functioning of internal control by recommending continuous improvement;	2.4. Ocenjuje funkcionisanje interne kontrole preporučujući kontinuirano poboljšanje;
2.5. Raporton rezultatet e auditimeve tek Drejtori Ekzekutiv i Administratës Tatimore;	2.5.Reports the results of audits to the Executive Director of Tax Administration;	2.5. Izveštava izvršnog direktora Poreske administracije o rezultatima revizija;
2.6. Përcjell implementimin e rekomandimeve të dhëna nga njësitë përkatëse organizative që kanë qenë objekt auditimi;	2.6.Follows up the implementation of recommendations given by the relevant organizational units that have been audited;	2.6. Prati sprovođenje preporuka datih od strane relevantnih organizacionih jedinica koje su bile predmet revizije;
2.7. Raporton në Njësinë Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;	2.7.Reports to the Central Harmonization Unit for Internal Audit within the Ministry of Finance, Labor and Transfers;	2.7. Izveštava Centralnu jedinicu za usklađivanje pri Ministarstvu finansija, rada i transfera u vezi interne revizije
2.8. Bashkëpunon me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm në fushën e auditimit.	2.8.Collaborates with the Office of the Auditor General in the field of auditing.	2.8. Sarađuje sa Kancelarijom generalnog revizora u oblasti revizije.
3.Njësia e Auditimit të Brendshëm udhëhiqet nga Drejtori i Njësisë dhe i raporton Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore.	3.The Internal Audit Unit is headed by the Director of the Unit and reports to the Executive Director of the Tax Administration.	3.Jedinicu za unutrašnju reviziju vodi direktor Jedinice i izveštava izvršnom direktoru Poreske administracije.
4.Numri i të punësuarve në këtë njësi është: katër (4).	4.The number of employees in this unit is: four (4).	4.Broj zaposlenih u ovoj jedinici je: četiri (4).

Neni 63 Divizioni i Burimeve Njerëzore	Article 63 Human Resources Division	Član 63 Odsek za Ljudske Resurse
1.Misioni i Divizionit të Burimeve Njerëzore është respektimi i të gjitha ligjeve si dhe të gjitha akteve nënligjore që kanë të bëjnë me menaxhimin e personelit në ATK, duke ofruar shërbime përkatëse për gjithë stafin si dhe mbështetje për ngritje profesionale si dhe zhvillim të aktiviteteve operacionale dhe funksionale drejt arritjes së objektivave strategjike të ATK-së.	1. The mission of the Human Resources Division is to comply with all laws and all bylaws related to staff management in TAK, providing relevant services for all staff and support for professional development and development of operational activities and functional towards achieving the strategic objectives of TAK.	1.Misija Odseka za ljudske resurse je poštovanje svih zakona i svih podzakonskih akata koji se odnose na upravljanje osobljem u PAK, pružanjem relevantnih usluga za osoblje i podršku za profesionalni razvoj i razvoj operativnih i funkcionalnih aktivnosti u pravcu postizanja strateških ciljeva PAK-a.
2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Burimeve Njerëzore janë:	2. The duties and responsibilities of the Human Resources Division are:	2.Dužnosti i odgovornosti Odseka za ljudske resurse su:
2.1. Përcakton objektivat në përputhje me strategjinë dhe objektivat e ATK-së në fushën e e burimeve njerëzore;	2.1. Sets the objectives in accordance with the strategy and objectives of TAK in the field of human resources;	2.1. Postavlja ciljeve u skladu sa strategijom i ciljevima PAK-a u oblasti ljusdkih resursa;
2.2. Ofron udhëzime nga fusha e burimeve njerëzore për të ofruar shërbime cilësore që janë relevante me funksionet e divizionit;	2.2. Provides guidance in the field of human resources to provide quality services that are relevant to the functions of the division;	2.2. Daje uputstva u oblasti ljudskih resursa za pružanje kvalitetnih usluga koje su relevantne za funkcionisanje Odseka;
2.3. Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme dhe rekomandon ndryshime/përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetet në punë;	2.3. Analyzes and evaluates internal processes and procedures and recommends changes/improvements in order to increase work efficiency;	2.3. Analizira i ocenjuje interne procese i procedure i preporučuje izmene/poboljšanja u cilju povećanja efikasnosti rada;
2.4. Zhvillon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave dhe procedurave dhe ofrimin e shërbimeve rreth burimeve njerëzore;	2.4. Develops and oversees the implementation of policies and procedures and the provision of services around Human Resources;	2.4. Razvija i nadgleda primenu politika i procedura i pružanje usluga u vezi sa ljudskim resursima;
2.5. Zhvillon dhe mirëmban nivele të	2.5. Develops and maintains levels of the	2.5. Razvija i održava nivoe najviših

standardeve më të larta dhe praktikave më të mira në menaxhimin e personelit në tërë Administratën Tatimore të Kosovës të bazuara në ligj dhe akte tjera nënligjore, në mënyrë të paanshme dhe efikase;	highest standards and best practices in staff management throughout the Tax Administration of Kosovo based on law and other bylaws, impartially and efficiently;	standarda i najboljih praksi u upravljanju osobljem u Poreskoj administraciji Kosova na osnovu zakona i drugih podzakonskih akata, na nepristrasan i efikasan način;
2.6. Siguron autoritetin punëdhënës dhe të punësuarit duke iu dhënë këshilla praktike që shkojnë në interes të profesionalizmit, në pajtim me Ligjin për Zyrtarët Publikë të Kosovës dhe Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat.	2.6. Provides employer authority and employees with practical advice in the interest of professionalism in accordance with the Law on Public Servants of Kosovo and the Law on Tax Administration and Procedures.	2.6. Osigurava organu poslodavca i zaposlenima praktične savete u interesu profesionalizma u skladu sa Zakonom o javnim službenicima Kosova i Zakonom o poreskoj administraciji i procedurama;
3.Divizioni për Burime Njerëzore udhëhiqet nga Udhëheqësi i Divizionit dhe i raporton Drejtorit Ekzekutiv.	3.The Human Resources Division is led by the head of the division and reports to the Executive Director.	3.Odsek za ljudske resurse vodi rukovodilac Odseka i izveštava izvršnom direktoru.
4.Numri i të punësuarve në këtë divizion është pesë (5).	4. The number of employees in this division is: five (5).	4.Broj zaposlenih u ovom Odseku je: pet (5).
Neni 64 **Divizioni i Prokurimit Publik**	**Article 64** **Public Procurement Division**	**Član 64** **Odsek za Javne Nabavke**
1.Misioni i Divizionit të Prokurimit Publik është që të kujdeset të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të buxhetit duke përcaktuar kushtet dhe rregullat ligjore që do të zbatohen në shfrytëzimin e mjeteve buxhetore dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë.	1.The mission of the Public Procurement Division is to take care to ensure the most efficient, transparent and fair way of using the Budget by defining the legal conditions and rules that will be applied in the use of budget funds and to be in accordance with the procedural and essential requirements of the Law on Public Procurement in Kosovo.	1.Misija Odseka za javne nabavke je da vodi računa o obezbeđivanju najefikasnijeg, najtransparentnijeg i najpravilnijeg načina korišćenja budžeta utvrđivanjem zakonskih uslova i pravila koja će se primenjivati u korišćenju budžetskih sredstava i koja su u skladu sa proceduralnim i suštinskim zahtevima Zakona o javnim nabavkama na Kosovu.
2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Prokurimit Publik janë:	2.Duties and responsibilities of the Public Procurement Division are:	2.Dužnosti i odgovornosti Odseka za javne nabavke su:

2.1. Koordinon dhe menaxhon aktivitetet e prokurimit dhe siguron që të gjitha procedurat dhe aktivitetet e prokurimit të zhvillohen në pajtim me ligjin që rregullon procedurat e prokurimit në Kosovë;	2.1.Coordinates and manages procurement activities and ensures that all procurement procedures and activities are conducted in accordance with the law governing procurement procedures in Kosovo;	2.1. Koordinira i upravlja aktivnostima javne nabavke i obezbeđuje da se sve procedure i aktivnosti nabavke sprovode u skladu sa zakonom koji uređuje proceduru za javne nabavke na Kosovu;
2.2. Bashkëpunon me të gjitha njësitë organizative brenda institucionit me qëllim të hartimit të planit strategjik të prokurimit (planifikimi preliminar dhe përfundimtar i prokurimit) për Administratën Tatimore;	2.2.Cooperates with all organizational units within the institution in order to draft a strategic procurement plan (preliminary and final procurement planning) for the Tax Administration;	2.2. Sarađuje sa svim organizacionim jedinicama u okviru institucije u cilju izrade strateškog plana za javne nabavke (prethodno i konačno planiranje javnih nabavki) za Poresku administraciju;
2.3. Koordinon punët mes njësive duke siguruar që të gjitha kërkesat për prokurim për mallra, shërbime, punë apo shërbime konsulente janë në rregull dhe të nënshkruara nga personat përgjegjës dhe janë në harmoni me procedurat e prokurimit;	2.3.Coordinates work between units ensuring that all procurement requests for goods, services, works or consulting services are in order and signed by the responsible persons and which are in accordance with the procurement procedures;	2.3. Koordinira rad između jedinica obezbeđujući da svi zahtevi za nabavku roba, usluga, radova ili konsultantskih usluga budu uredni i potpisani od odgovornih lica i da su u skladu sa procedurama za javne nabavke;
2.4. Organizon funksionimin e mirëfilltë të procesit të prokurimit, dhënien e këshillave dhe sugjerimeve profesionale në lidhje me zbatimin e procedurave të prokurimit për komisionet e vlerësimit dhe sipas nevojës edhe për zyrtarët tjerë kur kërkohet;	2.4.Organizes the proper functioning of the procurement process, providing professional advice and suggestions regarding the implementation of procurement procedures for evaluation commissions and, if necessary, for other officials when required;	2.4. Organizuje pravilno funkcionisanje procesa javnih nabavki, pružajući stručne savete i sugestije u vezi sa sprovođenjem procedura javnih nabavki za komisije za ocenjivanje i, ako je potrebno, za druge službenike po potrebi;
2.5. Përcakton metodat dhe procedurat e prokurimit për aktivitetet e prokurimit që parashihen të zhvillohen;	2.5.Defines the procurement methods and procedures for the procurement activities that are foreseen to take place;	2.5. Definiše metode i procedure javnih nabavki za aktivnosti javne nabavke koje su predviđene da se održe.
2.6. Kontrollon faturat që të jenë në përputhje me kontratën, përgatitjen e urdhërblerjeve, shënimet e mallrave të	2.6.Checks invoices to be in accordance with the contract, preparation of purchase orders, records of goods received, records	2.6. Proverava da li su fakture u skladu sa ugovorom, priprema narudžbine, evidencije primljene robe, evidenciju isporuke robe,

pranuara, shënimet e dorëzimeve, mallrat në kthim etj., secila e nënshkruar nga zyrtarët e përcaktuar, dhe në raste të arsyeshme, dorëzimin e certifikatës, aprovimin e komisionit ose certifikatën e përfundimit të kontratës, nëse nuk është e rregulluar ndryshe në Autoritetet Kontraktuese;	of deliveries, goods in return, etc., each signed by designated officials and in reasonable cases, certificate delivery, commission approval or the certificate of termination of the contract, unless otherwise regulated by the Contracting Authorities;	itd., svaka potpisana od strane ovlašćenih službenika u razumnim slučajevima, isporuka sertifikata, odobrenje komisije ili sertifikat o raskidu ugovora, osim ako Ugovorni organ nije drugačije regulisao;
2.7. Përcjell dështimet e kontraktorëve të cilët nuk kanë arritur t'i përmbushin obligimet e tyre kontraktuale kurdo që informohet nga Menaxheri i Projektit në lidhje me kompensimet e duhura, likuidimin e dëmeve dhe aranzhimin e anulimit të kontratave;	2.7.Follows up the failures of contractors who have failed to meet their contractual obligations whenever informed by the Project Manager regarding appropriate compensation, liquidation of damages and arrangement of contract cancellation;	2.7. Prati propuste ugovarača koji nisu ispunili svoje ugovorne obaveze kad god ga menadžer projekta obavesti o odgovarajućoj nadoknadi, likvidaciji štete i dogovoru o otkazivanju ugovora;
2.8. Përgatit njoftimin paraprak (njoftimi indikativ) të prokurimit si dhe përgatit raporte mbi kontratat e nënshkruara publike dhe përkujdeset për dorëzimin e tyre në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik;	2.8.Prepares the preliminary procurement notice (indicative notice) as well as reports on the signed public contracts and takes care of their submission to the Public Procurement Regulatory Commission;	2.8. Priprema prethodno obaveštenje (indikativno obaveštenje) za javne nabavke i priprema izveštaje o potpisanim javnim ugovorima i stara se o njihovom dostavljanju Regulatornoj komisiji za javne nabavke;
2.9. Mban kontakte në mes të ATK-së dhe AQP-së, OSHP-së, KRPP-së lidhur me inicimin dhe realizimin e procedurave të prokurimit dhe raporton sipas kërkesave që paraqiten pranë institucioneve kompetente.	2.9.Maintains contacts between TAK and CPA, PRB, PPRC, regarding the initiation and implementation of procurement procedures and reports according to requests submitted to the competent institutions.	2.9. Održava kontakte između PAK-a i CAN-a, TRN-a, RKJN-a, u vezi pokretanja, sprovođenja procedura javnih nabavki i izveštaja prema zahtevima dostavljenim nadležnim institucijama.
3.Divizioni i Prokurimit udhëhiqet nga Udhëheqësi i Divizionit dhe i raporton Drejtorit Ekzekutiv.	3.The Procurement Division is led by the head of the division and reports to the Executive Director.	3.Odsek za javne nabavke vodi rukovodilac Odseka i izveštava izvršnom direktoru.
4.Numri i të punësuarve në këtë divizion është tre (3).	4.The number of employees in this division is: three (3).	4. Broj zaposlenih u ovom Odseku je: tri (3).

Neni 65 Divizioni për Buxhet dhe Financa	Article 65 Budget and Finance Division	Član 65 Odsek za budžet i Finansije
1.Divizioni për Buxhet dhe Financa është njësi organizative dhe ka për mision që të merret me çështjet e planifikimit, menaxhimit, shpenzimit të buxhetit që i ndahet Administratës Tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi.	1. The Budget and Finance Division is an organizational unit and has the mission to deal with issues of planning, managing, spending the budget allocated to the Tax Administration in accordance with applicable law.	1.Odsek za budžet i finansije je organizaciona jedinica i ima zadatak da se bavi pitanjima planiranja, upravljanja, budžetske potrošnje dodeljenih Poreskoj administraciji u skladu sa važećim zakonom.
2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Buxhet dhe Financa janë:	2.The duties and responsibilities of the Budget and Finance Division are:	2.Dužnosti i odgovornosti Odseka za budžet i finansije su:
2.1. Menaxhon buxhetin e ATK-së në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin e Buxhetit për vitin përkatës të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës dhe procedurat dhe rregullat tjera që zbatohen në Kosovë për administrimin e buxhetit;	2.1. Manages the TAK budget in accordance with the Medium-Term Expenditure Framework, the Law on Public Financial Management and Accountability, the Law on Budget for the respective year approved by the Assembly of Kosovo and other procedures and rules applicable in Kosovo for budget administration;	2.1. Upravlja budžetom PAK-a u skladu sa Srednjoročnim okvirom rashoda, Zakonom o upravljanju javnim finansijama i odgovornostima, Zakonom o budžetu za dotičnu godinu usvojenim od strane Skupštine Kosova i drugim procedurama i pravilima koja se primenjuju na Kosovu za upravljanje budžetom;
2.2. Përgatit buxhetin vjetor të ATK-së dhe kërkesat për ndarje buxhetore për aprovim nga Ministria e Financave;	2.2. Prepares the annual budget of TAK and budget allocation requests for approval by the Ministry of Finance;	2.2. Priprema godišnji budžet PAK-a i zahteve za raspodelu budžeta za usvajanje od strane Ministarstva finansija;
2.3. Sigurohet që ATK-ja i respekton qarkoret buxhetore dhe instruksionet administrative të Ministrisë së Financave për hartimin, rishikimin dhe ekzekutimin e buxhetit të ATK-së, si dhe aprovon pagat, ndalesat dhe veprimet tjera të nevojshme për pagat dhe monitoron shpenzimet e buxhetit për të gjitha kategoritë ekonomike si dhe komenton, vlerëson dhe aprovon në aspektin financiar projektet kapitale të ATK-së;	2.3. Ensures that TAK respects the budget circulars and administrative instructions of the Ministry of Finance for drafting, reviewing and executing the TAK budget, as well as approves salaries, prohibitions and other necessary actions for salaries and monitors budget expenditures for all economic categories and comments, evaluates and approves in financial terms, TAK capital projects;	2.3. Osigurava da PAK poštuje budžetske cirkulare i administrativna uputstva Ministarstva finansija za izradu, razmatranje i izvršenje budžeta PAK-a, kao i da odobrava plate, zabrane i druge neophodne radnje za plate i prati budžetske rashode za sve ekonomske kategorije, kao i daje komentare, procenjuje i odobrava u finansijskom smislu kapitalne projekte PAK-a;

2.4. Mban raporte me Departamentin e Thesarit dhe Departamentin e Buxhetit Qendror në Ministrinë e Financave për të gjitha çështjet buxhetore;	2.4. Maintains relations with the Department of Treasury and the Department of Central Budget in the Ministry of Finance on all budget issues;	2.4. Održava odnose sa Odeljenjem za trezor i Odeljenjem za centralni budžet u Ministarstvu finansija o svim budžetskim pitanjima;
2.5. Harton raporte periodike për ecurinë e buxhetit në koordinim me Thesarin si dhe bën përgatitjen e gjendjes mujore të shpenzimeve;	2.5. Drafts periodic reports on the budget performance in coordination with the Treasury and prepares the monthly statement of expenditures;	2.5. Sastavlja periodične izveštaje o izvršenju budžeta i u koordinaciji sa Trezorom priprema mesečni izveštaj o rashodima;
2.6. Kryen kontrollin e inventarizimit të përgjithshëm të mjeteve kryesore, inventarin e imët dhe pasuritë tjera të ATK-së;	2.6. Performs control of general inventory of fixed assets, small inventory and other assets of TAK;	2.6. Vrši kontrolu opšteg inventara osnovnih sredstava, sitnog inventara i druge imovine PAK-a;
2.7. Mbikëqyr ditarin e shpenzimeve në bazë të zërave ekonomikë. Aprovon urdhërpagesat për të gjitha blerjet dhe detyrimet;	2.7. Supervises the expenditure diary based on economic items. Approves payment orders for all purchases and liabilities;	2.7. Nadgleda dnevnik rashoda na osnovu ekonomskih stavki. Odobrava platne naloge za sve kupovine i obaveze;
2.8. Planifikon shpenzimet dhe bën raportimin financiar në baza periodike si dhe përgatit pasqyrat financiare të ATK-së - Organizatës Buxhetore.	2.8. Plans expenditures and prepares financial reports on a periodic basis as well as prepares financial statements of TAK - Budget Organization.	2.8. Planira rashode i priprema finansijske izveštaje na periodičnoj osnovi, kao i priprema finansijske izveštaje PAK-a – Budžetske organizacije.
3.Divizioni për Buxhet dhe Financa udhëhiqet nga Udhëheqësi dhe i raporton Drejtorit Ekzekutiv.	3.The Budget and Finance Division is headed by the head of the division and reports directly to the Executive Director.	3.Odsek za budžet i finansije vodi rukovodilac i izveštava i direktno izveštava izvršnom direktoru.
4. Numri i të punësuarve në këtë divizion është gjashtë (6).	4.The number of employees in this Division is six (6).	4.Broj zaposlenih u ovom Odseku je šest (6).

Neni 66 Divizioni i Standardeve Profesionale	Neni 66 Professional Standards Division	Neni 66 Odsek za Profesionalne Standarde
1.Divizioni i Standardeve Profesionale ka mision të parandalojnë sjelljet jo të mira brenda ATK-së, si dhe të ofrojnë hetime të plota, efikase dhe objektive për rastet që kërcënojnë integritetin e ATK-së dhe dëmtojnë imazhin e saj.	1.The mission of the Professional Standards Division is to prevent misconduct within TAK, as well as to provide a thorough, efficient and objective investigation into cases that threaten TAK's integrity and damage its image.	1.Odsek za profesionalne standarde ima misiju da spreči nedolično ponašanje unutar PAK-a, kao i da obezbede temeljnu, efikasnu i objektivnu istragu u slučajevima koji ugrožavaju integritet PAK-a i narušavaju njen ugled.
2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Standardeve Profesionale janë:	2.The duties and responsibilities of the Professional Standards Division are:	2.Dužnosti i odgovornosti Odseka za profesionalne standarde su:
2.1. Heton rastet disiplinore dhe përgatit raporte hetuese lidhur me këto raste;	2.1.Investigates disciplinary cases and prepares investigative reports related to these cases;	2.1. Istražuje disciplinske slučajeve i priprema istražne izveštaje u vezi sa ovim predmetima;
2.2. Pranon dhe analizon formularë të deklaratave të pasurisë dhe atyre të konfliktit të interesit;	2.2.Receives and analyzes asset and conflict of interest declaration forms;	2.2. Prima i analizira obrasce za prijavu imovine i obrasce sukoba interesa;
2.3. Verifikon biografinë e të punësuarve;	2.3.Verifies the biography of employees;	2.3. Proverava biografiju zaposlenih;
2.4. Inspekton respektimin e rregullave të sjelljes nga zyrtarët e Administratës Tatimore;	2.4.Inspects the observance of the rules of conduct by the officials of the Tax Administration;	2.4. Proverava poštovanje pravila ponašanja službenih lica Poreske administracije;
2.5. Monitoron implementimin e Kodit të Etikës dhe Mirësjelljes për ATK-në;	2.5.Monitors the implementation of the Code of Ethics and Conduct for TAK;	2.5. Nadgleda primenu Kodeksa etike i ponašanja za PAK;
2.6. Ofron trajnime dhe këshilla për stafin lidhur me Kodin e Etikës dhe Mirësjelljes për ATK-në;	2.6.Provides training and advice to staff regarding the Code of Ethics and Conduct for TAK;	2.6. Pruža obuku i savete osoblju u vezi sa Kodeksom etike i ponašanja za PAK;
2.7. Bashkëpunon me institucione tjera për çështje që ndërlidhen e fushëveprimin e këtij	2.7.Cooperates with other institutions on issues related to the scope of this division;	2.7. Sarađuje sa drugim institucijama po pitanjima iz delokruga ovog Odseka;

divizioni; 2.8. Menaxhon linjën online dhe kutitë e vërejtjeve dhe sugjerimeve nga ana e palëve të ndryshme; 2.9. Monitoron implementimin e përgjegjësive nga strategjia kundër korrupsionit, plani i veprimit kundër korrupsionit, si dhe raporton për implementimin e tyre në Agjencinë Kundër Korrupsionit. 3.Divizioni i Standardeve Profesionale udhëhiqet nga Udhëheqësi i Divizionit dhe i raporton direkt Drejtorit Ekzekutiv. 4.Numri i të punësuarve në këtë divizion është katër (4).	2.8.Manages the Online line and boxes of remarks and suggestions from different parties; 2.9.Monitors the implementation of responsibilities from the anti-corruption strategy, the anti-corruption action plan, and reports on their implementation to the Anti-Corruption Agency. 3.The Professional Standards Division is headed by the Head of Division and reports directly to the Executive Director. 4.The number of employees in this division is: four (4).	2.8. Upravlja online linijom i kutijama za primedbe i sugestije različitih strana; 2.9. Nadgleda sprovođenje obaveza iz strategije za borbu protiv korupcije, akcionog plana protiv korupcije, i izveštava o njihovom sprovođenju u Agenciji za borbu protiv korupcije. 3.Odsek za profesionalne standarde vodi rukovodilac Odseka i direktno izveštava izvršnom direktoru. 4.Broj zaposlenih u ovom Odseku je: četiri (4).
Neni 67 **Divizioni për Komunikim me Media** 1.Divizioni për Komunikim me Media është njësi e pavarur e cila ka mision koordinimin e aktiviteteve që ndërlidhen me mediat dhe publikun në përgjithësi. 2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Komunikim me Media janë: 2.1. Koordinon kontaktet e Drejtorit Ekzekutiv me media si dhe udhëheq dhe përgatit të gjitha komunikatat, njoftimet dhe ftesat për media;	**Article 67** **Media Communication Division** 1.The Media Communication Division is an independent unit whose mission is to coordinate activities related to the media and the general public. 2.The duties and responsibilities of the Media Communication Division are: 2.1.Coordinates the Executive Director's contacts with the media and manages and drafts all press releases, announcements and invitations for the media;	**Član 67** **Odsek za Komunikaciju sa Medijima** 1.Odsek za komunikaciju sa medijima je nezavisna jedinica čija je misija koordinacija aktivnosti koje se odnose na medije i širu javnost. 2.Dužnosti i odgovornosti Odseka za komunikaciju sa medijima su: 2.1. Koordinira kontakte izvršnog direktora sa medijima, vodi i priprema sva saopštenja, obaveštenja i pozive za medije;

2.2. Koordinon dhe përgatit të gjitha pyetjet e gazetarëve, inicion dhe koordinon intervista, prononcime për media;	2.2.Coordinates and prepares all questions of journalists, initiates and coordinates interviews, statements for the media;	2.2. Koordinira i priprema sva pitanja novinara, inicira i koordinira intervjue, izjave za medije;
2.3. Përgatit të gjitha materialet/prezantimet e duhura për këto intervista, organizon konferencat e rregullta për media, takimet për media, vizita të ndryshme, bën monitorimin e mediave, publikimin e informacioneve relevante të stafit;	2.3.Prepares all the necessary materials/presentations for these interviews, organizes regular press conferences, media meetings, various visits, monitors the media, publishes relevant staff information;	2.3. Priprema sve potrebne materijale/prezentacije za ove intervjue, organizuje redovne konferencije za štampu, sastanke sa medijima, razne posete, prati medije, objavljuje relevantne kadrovske informacije;
2.4. Monitoron publikimet për media nga ATK-ja duke elaboruar artikujt dhe komunikatat për media mbi çështjet e rëndësishme rreth ATK-së, identifikon dhe përzgjedh materialet që duhet përfshirë në aktivitetet për media;	2.4.Monitors media publications by TAK by elaborating articles and press releases on important issues about TAK, identifies and selects materials to be included in media activities;	2.4. Nadgleda publikacije za medije PAK-a tako što elaborira članke i saopštenja za štampu o važnim pitanjima o PAKu, identifikuje i bira materijale koji će biti uključeni u medijske aktivnosti;
2.5. Koordinon punën me qëllim të publikimit dhe mirëmbajtës me materiale të nevojshme dhe përditëson informacionet dhe dokumentet që afishohen në faqen zyrtare të Administratës Tatimore;	2.5.Coordinates the work for the purpose of publication and maintenance with the necessary materials and updates the information and documents that are posted on the official website of the Tax Administration;	2.5. Koordinira rad u cilju objavljivanja i održavanja potrebnim materijalima i ažurira informacije i dokumente koji se objavljuju na zvaničnoj internet stranici Poreske administracije;
2.6. Koordinon punën me lektorin, për korrigjimin e dokumenteve të cilat publikohen në uebfaqe ose përcillen për media, siç janë komunikatat për shtyp, artikujt në gazeta, intervistat për media, përgjigjet për media, publikimet e ndryshme, dokumentet nga stafi i brendshëm si vendime, udhëzime administrative, kundërvajtje etj.	2.6.Coordinates the work with the editor, for the proofreading of documents which are published on the website or forwarded to the media, such as press releases, newspaper articles, media interviews, media responses, various publications, documents from internal staff such as decisions, administrative instructions, minor offenses, etc.	2.6. Koordinira rad sa lektorom, za ispravku dokumenata koji se objavljuju na veb stranici ili prosleđuju medijima, kao što su saopštenja za javnost, novinski članci, intervjui za medije, odgovori za medije, razne publikacije, dokumenta internog osoblja kao što su odluke, administrativna uputstva, prekršaji itd.

3.Divizioni për Komunikim me Media udhëhiqet nga Udhëheqësi i Divizionit dhe i raporton Drejtorit Ekzekutiv.	3.The Media Communication Division is led by the head of the division and reports to the Executive Director.	3.Odsek za komunikaciju sa medijima vodi rukovodilac Odseka i izveštava izvršnom direktoru.
4.Numri i të punësuarve në këtë divizion është tre (3).	4.The number of employees in this division is three (3).	4.Broj zaposlenih u ovom Odseku je tri (3).
KAPITULLI III ORGANIZIMI NË NIVEL LOKAL	**CHAPTER III ORGANIZATION AT LOCAL LEVEL**	**POGLAVLJE III ORGANIZACIJA NA LOKALNOM NIVOU**
Neni 68 Departamenti i Tatimpaguesve të Mëdhenj	**Article 68 Large Taxpayers Department**	**Član 68 Odeljenje za Velike Poreske Obveznike**
1.Departamenti i Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM) mbështet misionin e Administratës Tatimore përmes zbatimit të politikave në fushën e administrimit të tatimeve, duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi për të realizuar objektivat vjetore të përcaktuara nga Menaxhmenti i Lartë, duke u siguruar për trajtim të barabartë të tatimpaguesve në përputhje me kërkesat ligjore.	1. The Large Taxpayers Department (LTD) supports the mission of the Tax Administration through the implementation of policies in the field of tax administration, respecting the tax legislation in force to achieve the annual objectives set by the Senior Management, ensuring equal treatment of taxpayers in accordance with legal requirements.	1.Odeljenje za velike poreske obveznike (OVPO) podržava misiju Poreske administracije kroz sprovođenje politika u oblasti poreske administracije, poštujući poresko zakonodavstvo na snazi za postizanje godišnjih ciljeva koje postavlja viša uprava, obezbeđujući jednak tretman poreskih obveznika u skladu sa zakonskim zahtevima.
2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Tatimpaguesve të Mëdhenj janë:	2. The duties and responsibilities of the Large Taxpayers Department are as follows:	2.Dužnosti i odgovornosti Odeljenja za velike poreske obveznike su:
2.1. Zbaton politikat dhe procedurat në fushën e administrimit të tatimeve për bizneset që i përkasin kategorisë së tatimpaguesve të mëdhenj;	2.1. Implements policies and procedures in the field of tax administration for businesses belonging to the category of large taxpayers;	2.1. Sprovodi politike i procedure u oblasti poreske administracije za preduzeća iz kategorije velikih poreskih obveznika;
2.2. Kontribuon që përmes aktiviteteve	2.2. Contributes that through operational	2.2. Doprinosi da kroz operativne aktivnosti

operative tek bizneset e mëdha, në përputhje me legjislacionin tatimor, të arrijnë përmbushjen e të hyrave të planifikuara për buxhetin e shtetit;	activities to large businesses in accordance with tax legislation to achieve the fulfilment of revenues planned for the state budge;	velika preduzeća u skladu sa poreskim zakonodavstvom ostvare ispunjenje prihoda planiranih za državni budžet;
2.3. Kontribuon në përmbushjen e detyrave tjera të përcaktuara nga Menaxhmenti i ATK-së;	2.3. Contributes to the fulfilment of other tasks defined by the Management of TAK;	2.3. Doprinosi ispunjavanju drugih zadataka definisanih od strane uprave PAK-a;
2.4. Koordinon aktivitetet përmes vizitave përmbushëse, kontrollit dhe aktiviteteve të tjera në DTM me qëllim që të kompletohen të gjitha veprimet për zbatimin e ligjit;	2.4. Coordinates activities through follow-up visits, inspections and other activities in DLT in order to complete all law enforcement actions;	2.4. Koordinira aktivnosti kroz posete usklađenosti, kontrole i drugih aktivnosti u OVPO-u u cilju završetka svih radnji za sprovođenje zakona;
2.5. Koordinon punën me Divizionin për Menaxhimin e Riskut në identifikimin e rreziqeve të përmbushjes;	2.5.Coordinates work with the Risk Management Division in identifying compliance risks;	2.5. Koordinira rad sa Odeljenjem za upravljanje rizicima u identifikovanju rizika usklađenosti;
2.6. Identifikon dhe monitoron matësit kyç të performancës.	2.6. Identifies and monitors key performance measures.	2.6. Identifikuje i prati ključne mere učinka.
3.Drejtori i Departamentit të Tatimpaguesve të Mëdhenj raporton tek Zëvendësdrejtori Ekzekutiv 1.	3.The Director of the Large Taxpayers Department reports to the Deputy Executive Director 1.	3.Direktor Odeljenja za velike poreske obveznike izveštava zameniku izvršnog direktora 1.
4.Në kuadër të këtij departamenti bëjnë pjesë:	4. Within this Department are the following divisions:	4. U okviru ovog Odeljenja su:
4.1. Divizioni për Aktivitete Operative;	4.1.Operational Activities Division;	4.1. Odsek za operativne aktivnosti;
4.2. Divizioni për Shërbime Mbështetëse;	4.2.Support Services Division;	4.2. Odsek za usluge podrške;
4.3. Divizioni për Analizë të Riskut.	4.3. Risk Analysis Division.	4.3. Odsek za analizu rizika.
5.Numri i të punësuarve në Departamentin e	5.The number of employees in the Large	5. Broj zaposlenih u Odeljenju za velike

Tatimpaguesve të Mëdhenj është dyzet e tetë (48).	Taxpayers Department shall be forty-eight (48)	poreske obveznike je četrdeset osam (48)
Neni 69 **Divizioni për Aktivitete Operative**	**Article 69** **Operational Activities Division**	**Član 69** **Odsek za Operativne Aktivnosti**
1.Divizioni për Aktivitete Operative është njësi organizative në kuadër të Departamentit të Tatimpaguesve të Mëdhenj, i cili përmes aktiviteteve operative në terren mbështet misionin e këtij departamenti.	1.The Operational Activities Division is an organizational unit within the Large Taxpayers Department which through operational activities in the field supports the mission of this Department.	1.Odsek za operativne aktivnosti je organizaciona jedinica u okviru Odjeljenja za velike poreske obveznike koji kroz operativne aktivnosti na terenu podržava misiju ovog Odjeljenja.
2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Aktivitete Operative janë:	2.The duties and responsibilities of the Operational Activities Division are as follows:	2.Dužnosti i odgovornosti Odseka za operativne aktivnosti su:
2.1. Ndërmerr aktivitete operative përmes inspektorëve tatimorë, duke siguruar trajtim të drejtë dhe të barabartë për të gjitha bizneset;	2.1.Undertakes operational activities through tax inspectors, ensuring fair and equal treatment for all businesses;	2.1.Preduzima operativne aktivnosti preko poreskih inspektora, obezbeđujući pravičan i jednak tretman za sva preduzeća;
2.2. Analizon rekomandimet mbi rastet e përcaktuara për kontroll sipas prioriteteve dhe bazuar në analizën e riskut dhe ndërmerr veprime konkrete në terren;	2.2.Analyses the recommendations on the cases defined for control according to priorities and based on the risk analysis and undertakes concrete actions in the field;	2.2. Analizira preporuke o slučajevima definisanim za kontrolu prema prioritetima i na osnovu analize rizika i preduzima konkretne radnje na terenu;
2.3. Koordinon aktivitetet për identifikimin e fushave potenciale të mospërmbushjes dhe ndërmerr veprime të nevojshme sipas planit të përcaktuar nga Menaxhmenti i ATK-së;	2.3.Coordinates activities for the identification of potential areas of non-compliance and takes necessary actions according to the plan set by the Management of TAK;	2.3. Koordinira aktivnosti za identifikaciju potencijalnih oblasti neusaglašenosti i preduzima potrebne radnje prema planu utvrđenom od strane uprave PAK-a;
2.4. Koordinon punën e këshilltarëve tatimorë në Departamentin e Tatimpaguesve të Mëdhenj, në atë mënyrë që komunikimi me bizneset të jetë profesional dhe mbi bazë ligjore;	2.4.Coordinates the work of tax advisors in the Large Taxpayers Department, in such a way that communication with businesses is professional and on a legal basis;	2.4. Koordinira rad poreskih savetnika u Odeljenju za velike poreske obveznike, na način da komunikacija sa privrednim subjektima bude profesionalna i na zakonskoj osnovi;

2.5. Kontribuon në ndërlidhjen me njësitë tjera organizative brenda ATK-së.	2.5.Contributes to liaison with other organizational units within TAK.	2.5. Doprinosi povezivanju sa drugim organizacionim jedinicama u okviru PAK-a.
3.Udhëheqësi i Divizionit për Aktivitete Operative raporton tek Drejtori i Departamentit të Tatimpaguesve të Mëdhenj.	3.The Head of Operational Activities Division reports to the Director of the Large Taxpayers Department.	3.Rukovodilac Odseka za operativne aktivnosti izveštava direktoru Odeljenja za velike poreske obveznike.
4.Numri i të punësuarve në Divizionin për Aktivitete Operative është tridhjetë e shtatë (37).	4.The number of employees in the Operational Activities Division shall be thirty-seven (37).	4.Broj zaposlenih u Odseku za operativne aktivnosti je trideset sedam (37).
Neni 70 **Divizioni për Shërbime Mbështetëse**	**Article 70** **Support Services Division**	**Član 70** **Odsek za usluge podrške**
1.Divizioni për Shërbime Mbështetëse është njësi organizative në kuadër të Departamentit të Tatimpaguesve të Mëdhenj, i cili përmes koordinimit të aktiviteteve përkrahëse për funksionimin normal mbështet misionin e këtij departamenti.	1. The Support Services Division is an organizational unit within the Large Taxpayers Department which through the coordination of support activities for normal functioning supports the mission of this Department	1. Odsek za usluge podrške je organizaciona jedinica u okviru Odeljenja za velike poreske obveznike koja kroz koordinaciju aktivnosti podrške za normalno funkcionisanje podržava misiju ovog Odeljenja.
2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Shërbime Mbështetëse janë:	2. The duties and responsibilities of the Support Services Division are as follows:	2.Dužnosti i odgovornosti Odseka usluge podrške su:
2.1. Koordinon dhe monitoron pjesën e logjistikës në kuadër të departamentit;	2.1. Coordinates and monitors the logistics part within the department;	2.1. Koordinira i prati logistički deo u okviru odeljenja;
2.2. Koordinon dhe monitoron pjesën e teknologjisë informative brenda departamentit.	2.2. Coordinates and monitors the part of information technology within the department.	2.2. Koordinira i prati deo informacionih tehnologija u okviru odeljenja.
2.3 Menaxhon nevojat e transportit dhe automjet dhe mban evidencën për hyrje dh dhe dalje;	2.3. Manages transport and vehicle needs and keeps records of entry and exit;	2.3. Upravlja potrebama za transport i vozila i vodi evidenciju ulaska i izlaska;

2.4. Menaxhon nevojat për inventar dhe pajisje tjera ;	2.4. Manages inventory and other equipment needs;	2.4. Upravlja potrebama za inventar i ostalu opremu;
2.5. Menaxhon me recepcionin;	2.5. Manages the reception;	2.5. Upravlja recepcijom;
2.6. Menaxhon dhe mirëmban sistemin e arkivit;	2.6. Manages and maintains the archive system;	2.6. Upravlja i održava sistem arhive;
2.7. Menaxhon dhe adminsitron me të gjitha shkresat hyrës dhe dalëse brenda Departamentit;	2.7. Manages and administers all incoming and outgoing documentation within the Department;	2.7. Upravlja i administrira svu ulaznu i izlaznu dokumentaciju u okviru odeljenja;
2.8. Adminsitron me klasifikimin e dosjeve sipas kritreve për klasifikim;	2.8. Administers the classification of files according to classification criteria;	2.8. Administrira klasifikaciju dosijea prema kriterijumima za klasifikaciju;
2.9. Ruan dokumentacionin në kasaforta të veçanta sipas s standardeve të përcaktuara.	2.9. Stores the documentation in special safety boxes according to the defined standards.	2.9. Čuva dokumentaciju u posebnim sefovima prema utvrđenim standardima.
3.Udhëheqësi i Divizionit për Shërbime Mbështetëse raporton tek Drejtori i Departamentit të Tatimpaguesve të Mëdhenj.	3.The Head of the Support Services Division reports to the Director of the Large Taxpayers Department.	3.Rukovodilac Odseka za usluge podrške izveštava direktoru Odjeljenja za velike poreske obveznike.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Shërbime Mbështetëse është shtatë (7).	4.The number of employees in the Support Services Division shall be seven (7).	4.Broj zaposlenih u Odseku za usluge podrške je sedam (7).
Neni 71 **Divizioni për Analizë të Riskut**	**Article 71** **Risk Analysis Division**	**Član 71** **Odsek za Analizu Rizika**
1.Divizioni për Analizë të Riskut është njësi organizative në kuadër të Departamentit të Tatimpaguesve të Mëdhenj, i cili përmes identifikimit të rreziqeve që lidhen me të hyrat	1.The Risk Analysis Division is an organizational unit within the Large Taxpayers' Department which, through the identification of risks related to revenues,	1.Odsek za analizu rizika je organizaciona jedinica u okviru Odeljenja za velike poreske obveznike koji kroz identifikaciju rizika u vezi sa prihodima podržava misiju ovog Odeljenja.

përkrah misionin e këtij departamentit.	supports the mission of this Department.	
2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Analizë të Riskut janë:	2.The duties and responsibilities of the Risk Analysis Division are:	2.Dužnosti i odgovornosti Odseka za analizu rizika su:
2.1. Identifikon rreziqet për Administratën Tatimore në katër fusha kryesore që lidhen me të hyrat: regjistrim, deklarim, raportim të saktë dhe pagesa;	2.1.Identifies risks for the Tax Administration in four main areas related to revenues: registration, declaration, accurate reporting and payment;	2.1. Identifikuje rizike za Poresku administraciju u četiri glavne oblasti u vezi sa prihodima: registracija, prijava, tačno izveštavanje i plaćanje;
2.2. Zhvillon vëzhgime të rregullta të mjedisit për t'i identifikuar pengesat potenciale në arritjen e Planit Vjetor të Punës së DTM-së dhe Planit Strategjik;	2.2.Conducts regular environmental surveys to identify potential obstacles to achieving the LTD Annual Work Plan and Strategic Plan;	2.2. Sprovodi redovna posmatranja okruženja kako bi identifikovao potencijalne prepreke za postizanje godišnjeg plana rada i strateškog plana OVPO-a;
2.3. Analizon të gjitha informatat e pranuara për të përcaktuar fushat potenciale të rreziqeve për të hyrat e Administratës Tatimore dhe zhvillon trajtimin e propozuar për rrezik;	2.3.Analyzes all information received to determine potential risk areas for Tax Administration revenues and develops proposed risk treatment;	2.3. Analizira sve primljene informacije radi utvrđivanja potencijalnih rizičnih područja za prihode Poreske administracije i razvija predloženi tretman rizika;
2.4. Analizon të dhënat sipas industrisë, llojeve të tatimpaguesve (korporata, individuale, korporata të mëdha, korporata të vogla, individuale të mëdha, individuale të vogla, SH.P.K. etj.);	2.4.Analyzes data by industry, types of taxpayers (corporate, individual, large corporations, small corporations, large individuals, small individuals, LLC, etc.);	2.4. Analizira podatke po delatnostima, vrstama poreskih obveznika (korporativni, individualni, velike korporacije, male korporacije, veliki poreski obveznici, mali poreski obveznici, DOO, itd.);
2.5. Monitoron fushat e rrezikut për të përcaktuar nëse trajtimi i subjekteve në DTM është adekuat dhe efektiv;	2.5.Monitors risk areas to determine whether the treatment of entities in the LTD is adequate and effective;	2.5. Prati područja rizika kako bi utvrdio da li je tretman subjekata u OVPO adekvatan i efikasan.
2.6. Harton raporte të shkruara mbi fushat me rrezik, identifikon rrezikun, arsyen përse është rrezik dhe metodat e mundshme të adresimit të rrezikut (trajtimit të rrezikut);	2.6.Drafts written reports on risk areas, identifies the risk, why it is a risk and possible methods of addressing the risk (risk management);	2.6. Sastavlja pisane izveštaje o oblastima rizika, identifikuje rizik, zašto je rizik i moguće metode rešavanja rizika (tretmana rizika);

2.7. Monitoron masat e performancës për t'i identifikuar të mirat dhe dobësitë;	2.7.Monitors performance measures to identify strengths and weaknesses;	2.7. Prati mere učinka kako bi identifikovao prednosti i slabosti;
2.8. Analizon arsyet dhe përgatit rekomandimet konkrete për t'i adresuar çështjet sipas nevojës.	2.8.Analyzes reasons and prepares concrete recommendations to address issues as needed.	2.8. Analizira razloge i priprema konkretne preporuke za rešavanje problema po potrebi;
3.Udhëheqësi i Divizionit për Analizë të Riskut raporton tek Drejtori i Departamentit të Tatimpaguesve të Mëdhenj.	3.The Head of the Risk Analysis Division reports to the Director of the Large Taxpayers Department.	3.Rukovodilac Odseka za analizu rizika izveštava direktoru Odeljenja za velike poreske obveznike.
4.Numri i të punësuarve në Divizionin për Analizë të Riskut është tre (3).	4.The number of employees in the Risk Analysis Division is three (3).	4.Broj zaposlenih u Odseku za analizu rizika je tri (3).
Neni 72 **Departamenti i Tatimpaguesve të Mesëm**	**Article 72** **Medium Taxpayer Department**	**Član 72** **Odeljenje za Srednje Poreske Obveznike**
1.Departamenti i Tatimpaguesve të Mesëm (DTMS) mbështet misionin e Administratës Tatimore përmes zbatimit të politikave në fushën e administrimit të tatimeve, duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi për të realizuar objektivat vjetore të përcaktuara nga Menaxhmenti i Lartë, duke u siguruar për trajtim të barabartë të tatimpaguesve në përputhje me kërkesat ligjore.	1.The Medium Taxpayer Department (MTD) supports the mission of the Tax Administration through the implementation of policies in the field of tax administration, respecting the tax legislation in force to achieve the annual objectives set by the Senior Management, ensuring equal treatment of taxpayers in accordance with legal requirements.	1.Odeljenje za srednje poreske obveznike (OSPO) podržava misiju Poreske administracije kroz sprovođenje politika u oblasti poreske administracije, poštujući poresko zakonodavstvo na snazi za postizanje godišnjih ciljeva koje postavlja viša uprava, obezbeđujući jednak tretman poreskih obveznika u skladu sa zakonskim zahtevima.
2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Tatimpaguesve të Mesëm janë:	2.The duties and responsibilities of the Medium Taxpayer Department are:	2.Dužnosti i odgovornosti Odeljenja za srednje poreske obveznike su:
